

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“AL.IT PROJECTS” Sh.p.k**

*I. THEMELIMI*

**NENI 1**

**Ortakët themelues**

Shoqëria krijohet nga ortakët themelues:

- **Z. Rocco Campenni'** , shtetatas italian, lindur më Scilla (RC) , Rajoni Reggio Calabria , Itali, me 03.12.1981 , identifikuar me nr. ID YC 0840516 , madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.
- **Z. Davide Carlo Galeone** , shtetatas italian, lindur Milano (MI) , Itali me 19.02.1979, identifikuar me nr. ID YB 5008659 , madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.
- **Z. Pasquale Pacicca** , shtetatas italian, lindur ne Reggio Calabria (RC) , Itali me 18.07.1994 identifikuar me nr. ID YA 5136605 , madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.

*II. EMERTIMI – SELIA – FORMA JURIDIKE – OBJEKTI*

**NENI 2**

**Emertimi**

Shoqëria emertohet **AL.IT PROJECTS Sh.p.k.**

**NENI 3**

**Forma juridike**



Shoqëria **AL.IT PROJECTS Sh.p.k.** themelohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.) sipas Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per shoqëritë Tregtare”.

**NENI 4**

**Selia**

4.1 Shoqëria **AL.IT PROJECTS Sh.p.k.** e ka selinë e saj në adresën Tiranë , Njësia administrative nr 7 , “Rruga e Kavajës” , pallati “Square 21” , kati i 8 , apartamenti nr 1 , zona kadastrale nr 8250 , numer pasurie 1/707 + 4 – 43.

4.2 Shoqëria vepron si person juridik shqiptar dhe si e tillë mund të kryejë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj, nëpërmjet filialeve, degëve, zyrave të përfaqësimit ose agjensite të saj, të cilat janë krijuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.



## NENI 5

### Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë

5.1. Shoqëria "AL.IT PROJECTS" Sh.p.k ushtron veprimtarinë e saj me qëllim realizimin e fitimit, duke u mbështetur në parimet dhe rregullat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

5.2. Veprimtaria e Shoqërisë "AL.IT PROJECTS" Sh.p.k, do të ketë për objekt:

5.2.1 Ofrimi i shërbimeve të integruara dhe multidisiplinare për prodhimin dhe zbatimin e projekteve të ndërtimit nëpërmjet veprimtarisë së menaxhimit , organizimit, mbikëqyrjes, projektimit, koordinimit teknik dhe konsulencës, me kontrollin e çdo faze drejtuese , për kryerjen e studimeve profesionale për shoqëritë që operojnë në sektorin e lartpërmendur.

Sigurimi i furnizimeve teknike, organizative dhe komerciale në sektorin e ndërtimit dhe sektorët përkatës , si dhe në sektorët e inxhinierisë së impianteve , mobilimit dhe montimit , të gjitha të kryhen në mënyrë të integruar dhe të plotë , me kontroll dhe inovacion të menaxhimit dhe procesi i ndërtimit që synon të garantojë zgjidhje moderne , me standarde të larta cilësie.


Kryerja e punimeve të ndërtimit në përgjithësi , mirëmbajtja dhe ruajtja e pasurive të paluajtshme , prishja , ndërtimi , ristrukturimi , restaurimi , rehabilitimi , rikuperimi i pasurive të paluajtshme. Blerja për menaxhim dhe për shitje të pasurive të paluajtshme.

Ndërtimi i komplekseve të pasurive të paluajtshme të çdo natyre si për vete ashtu edhe për llogari të të tretëve , si me ndërhyrje të drejtpërdrejtë ashtu edhe duke deleguar kryerjen e punimeve të të tretët. Menaxhimi në tërësi i pasurive të paluajtshme, në pronësi dhe në emër të të tretëve.

Dhenia me qira , përjashtuar qiran financiare, dhe dhënia me qira e mallrave dhe pajisjeve të qenësishme në fushat e mësipërme. Tregtia e mallrave, si lëndë e parë, ashtu edhe produkte gjysëm të gatshme dhe të gatshme, të qenësishme në fushat e mësipërme.

Shoqëria mund të japë gjithashtu miratime dhe garanci të të gjitha llojeve për këdo, për detyrimet dhe borxhet e palëve të treta , duke përfshirë joaksionarët, për të kryer çdo transaksion tregtar, industrial, financiar , të luajtshëm ose të pasurive të paluajtshme që organi administrativ e konsideron të dobishme ose të nevojshme për arritjen e qëllimit të shoqërisë , si dhe për të blerë dhe shitur drejtpërdrejt ose tërthorazi interesa ose aksione në shoqëri ose ndërmarrje të tjera, të krijuara ose që do të krijohen , që kanë një qëllim të ngjashëm ose në çdo rast të lidhur me qëllimin e saj.

5.2.2 Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë çdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin.

  
Dardë Celë Jellou

  
Pavao Baur

5.2.3 Shoqëria, me vendim të Administratorit, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.

5.3 Objekti i shoqërisë mund të ndryshojë, të zgjerohet ose të pakesohet në bazë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme.

### III. KOHEZGJATJA – KAPITALI I SHOQËRISË-VENDIMARRJA

#### **NENI 6**

##### **Kohezgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë për një periudhë kohore të pacaktuar.

#### **NENI 7**

##### **Kapitali i Shoqërisë**

7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë “**AL.IT PROJECTS Sh.p.k.**” Sh.p.k perfaqësohet nga 3 (tre) kuota me vlerë 1,200,000 (njëmijëlon e dyqind mij) leke dhe nuk është paguar. Kapitali do të paguhet në leke në llogarinë bankare të shoqërisë në një ose më shumë derdhje brenda një viti nga data e regjistrimit pranë Qendres Kombëtare të Biznesit QKB


Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë:

- **Z. Rocco Campenni'** : Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 400,080 (katërqind mijë e tetëdhjetë) Leke që përben 33.34 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- **Z. Davide Carlo Galeone** : Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 399,960 (treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) Leke që përben 33.33 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- **Z. Pasquale Pacicca** : Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 399,960 (treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) Leke që përben 33.33 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

#### **NENI 8**

##### **Asambleja e Përgjithshme**

8.1 Vendimet merren nga Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet që ligji apo Statuti ia rezervon këtij organi, si dhe për çështjet për të cilat, Administratori kërkon mendimin apo miratimin e Asamblesë së Përgjithshme.





8.2 Vendimet e Asamblesë së Pergjithshme merren me shkrim dhe regjistrohen ne nje regjister te posacem te mbajtur prane selise se Shoqerise "AL.IT PROJECTS" Sh.p.k.

8.3 Jane ne kompetencen ekskluzive te Asamblese së Ortakëve marrja e vendimeve per sa i perket:

- ndryshimit të Statutit;
- riorganizimi i shoqerise, ndarja, bashkimi, likuidimi, shnderrimi i shoqerise;
- zmadhimi, zvogelimi i kapitalit, transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar tek të tretët, si dhe blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar nga vete shoqeria me qellim anullimin e tyre;
- emerimi dhe shkarkimi i Administratorit;
- emerimi dhe shkarkimi i eksperteve kontabel te autorizuar;
- miratimi e bilancit;
- si dhe te gjitha kompetencat e tjera qe ligji dhe/ose Statuti japin shprehimisht Asamblese

## **NENI 9**

### **Organet drejtuese**

9.1. Organet drejtuese të Shoqërisë **AL.IT PROJECTS Sh.p.k.** janë:

- a) Asambleja e Pergjithshme në të cilën marrin pjesë Ortakët e Shoqërisë ose përfaqësuesit e tyre të pajisur më prokurë të veçantë; dhe
- b) Administratorët

## **NENI 10**

### **Administratori i Shoqërisë**

10.1 Shoqeria administrohet nga Administratori, person fizik qe mund te jetë ose jo ortak i Shoqërisë.

10.2 Administratori eshte të detyruar të drejtojë Shoqërinë **AL.IT PROJECTS shpk** në përputhje me ligjin "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Statutin, vendimet e Asamblesë së Pergjithshme dhe sipas dispozitave të tjera ligjore në fuqi.

10.3 Administratori i Shoqërisë emerohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Ortakëve, si dhe do te qendroje ne detyre per një kohë prej 5 (pese) vitesh.


10.4 Administratori i pare te shoqërisë emerohet:

- **Z. Mersed Bega** shtetatas shqiptar , lindur ne Bubullimë , Lushnjë , Shqipëri me 16.09.1991, identifikuar me nr. J10916025K , madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.

Nenshkrimi i administratorit

Mersed Bega 

10.5 Administratori ka te gjitha kompetencat qe i njej ligji dhe Statuti i Shoqerise.





## **NENI 11**

### **Ligi i zbatueshem dhe mosmarreshjet**

11.1 Per sa nuk parashikohet nga ky Akt Themelimi, reference i behet legjislacionit shqiptar ne fuqi.

11.2. Per te gjitha mosmarreshjet brenda shoqerise qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organi kompentent do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

11.3. Ky dokument redaktohet ne 4 (kater) kopje origjinale.

Lexuar, kuptuar, aprovuar e nenshkruar nga ortaket themelues .

### **ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE AL.IT PROJECTS SH.P.K.**

**Date 24.11.2022**

**Z.Rocco Campenni'**

**Z. Davide Carlo Galeone**

**Z. Pasquale Pacicca**



